



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 27.07.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1) të Rregullores për Prokurim Publik të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 25.07.2023, të parashtruar nga Operatori Ekonomik N.P.T. " **Bajra** ", lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me pajisje kundër zjarrit", Nr. i prokurimit- 632-23-6281-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-082 -121, **nxjerr:**

V E N D I M

1. **Refuzohet** si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim të Operatori Ekonomik N.P.T. " **Bajra** " e dt.25.07.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me pajisje kundër zjarrit", Nr. i prokurimit- 632-23-6281-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-082 -121, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të publikuar me datë 20.07.2023, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. **Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: 20.07.2023;

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

Ar sy e t i m

Operatori Ekonomik N.P.T. " Bajra " me dt.25.07.2023, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim , lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pajisje kundër zjarrit", Nr. i prokurimit- 632-23-6281-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-082 -121.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 27.07.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj i parë nuk qëndron, sepse Operatori ekonomik fitues ka dorëzuar deklaratën , njejtë siç është kërkuar në pikën 3.1 të FDT-së:

Specifikacionet teknike të detyrueshme	3.1	Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentet dëshmuese për qëllimin e ofruar të kontratës, duke përfshirë: a. Deklaratën për specifikacionet teknike për mallrat e ofruara të cilat përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit.
--	-----	--

DEKLARATË
ROA CONSULTING SH.P.K

Lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pajisje kundër zjarrit" me nr. të prokurimit: 632-23-6281-1-2-1 të autoritetit kontaktues "KOMUNA E GJAKOVËS "

ROA Consulting SH.P.K me seli në Saliabajë - Lluzhan p.n, Komuna Podujevë, me numër unik identifikues 811949364, delaron se:

- Pajisjet të cilat ju janë ofertuar dhe do të përdoren për këtë tender janë konform specifikave teknike të parashtruara nga Autoriteti Kontraktues si dhe në përputhshmëri me të gjitha aspektet dhe udhëzimet tjera në Aneksin 1 sipas dosjes së tenderit.
- Pajisjet të cilat ju janë ofertuar për këtë tender, do të dorëzohen brenda një periudhe prej 15 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.



Datë: 11/07/2023

Tel: +383 (0) 48 26 24 24
Email: roashpk@outlook.com

Pretendimi juaj i dytë, është i pakuptimt, sepse askund në FDT-ë nuk është kërkuar të dorëzohet Δ -Test për materialet e pompave shpinore;

Pretendimi juaj i tretë lidhur me referencat e prezantuara të Operatorit ekonomik fitues nuk qëndron sepse në FDT është kërkuar që të prezantohet së paku një referencë që d.m.th. se operatori ekonomik në fjalë në këtë pikë plotëson kërkesat e Autoritetit kontraktues nëFDT:



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
CENTAR PËR SHËRIM TË QYTETMËRIE
CENTAR ZA USLUGU GRADNINARSTVA
Nr. Ifaq. 02 Nr. 2462
Br. 17 Br. 13/03
Br. str. KAMENICËJA 2023

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Komuna e Kamenicës – rr. Skënderbeu pn, 62000 Kamenicë
ZYRA E PROKURIMIT
Datë: 13.03.2023

Me kërkesën e Operatorit Ekonomik **Roa Consulting " Sh.p.k** , Komuna e Kamenicës lëshon këtë:

R E F E R E N C Ë

Komuna e Kamenicës ka lidhur kontratë me **Roa Consulting " Sh.p.k** më datë 22.12.2022 për kryerjen e furnizimeve për kontratën :

Furnizim me pajisje për njësinë e zjarrfikësve

KM653-22-12074-1-3-6
KM653-22-070-136

Vlera e furnizimeve të përfunduara: 7 179,00€

Dhe ka kryer furnizimet me sukses sipas kontratës dhe specifikave të kërkuara.

Andaj rekomandojmë O.E **"Roa Consulting " Sh.p.k** për furnizime të natyrës së ngjashme.



V.D. Mënyheri i Prokurimit

Fitim Thaqi

Pretendimi juaj i katërt është i pabazuar, sepse as formula për tenderin abnormalisht të ulët nuk e përfshin çmimin e ofertës së Operatorit ekonomik fitues;

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.**

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

